

Konsultime me gra, viktima të luftës për themelimin e Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut në ish Jugosllavi

4. Dhjetor 2010.

Rahovec, Kosovë

Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (QHDP) nga Kosova, anëtare e Koalicionit për KOMRA, në kuadër të Inicativës për KOMRA (Iniciativa për themelimin e Komisionit Rajonal për gjetjen e fakteve të krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut në periudhën 1991-2001 në territorin e ish Jugosllavisë), ka organizuar konsultimet e para lokale me gra, viktima te luftës, më datë 4 dhjetor 2010, në Rahovec. Në këto konsultime morren pjesë 32 gra. Ato ishin të përkatësisë shqiptare, serbe dhe rome nga Rahoveci, Hoqa e Madhe dhe Krusha e Madhe.

Një numër i madh i mediave nuk iu përgjigjën ftesës, për arsye të zgjedhjeve parlamentare që mbaheshin atë kohë në Kosovë. Megjithatë, prezent ishte gazetari i së përditshmes 'Lajm' i cili shkroi një artikull rreth rrjedhës së takimit dhe Inicativës për KOMRA.

Në lidhje me pjesëmarrjen e grave-familjare të viktimave nga Komuna e Rahovecit.

Gjatë prezantimit të Inicativës për KOMRA, panelistët dhe moderatorja u munduan që të dekonstruktojnë konceptin e KOMRA-së, sepse niveli i arsimimit të grave ishte i ulët. Për më tepër, ato ende vuanin nga pasojat e humbjeve të përjetuara dhe kishin nevojë të shpreheshin e më pak të dëgjonin. Ato në mënyrë të drejtpërdrejtë flisnin për vuajtjet, ballafaqimin me të kaluarën, për gjetjen e kryerësve të krimeve, por edhe se si te vazhdohet tutje. Ato dhanë përgjigje shumë të qarta në pyetjet: Si do të reagonit nëse ju ballafaqoheni me vrasësin e burrit/vëllait tuaj, etj? A do të përballeshit me një vrasës? A do të amnestoni vrasësin? A besoni në sistemin e drejtësisë? A do të donit të dinit se kush i ka kryer krimet? A do të donit të dinit se ku janë varrezat masive?

Diskutimet kanë zgjatur ngase gratë kanë ndier nevojën për të treguar historitë e tyre, vuajtjet dhe kërkonin gjetjen e autorëve të krimeve, si dhe personave të zhdukur.

Në rrjedhën e diskutimeve, gratë shfaqën nevojën për të ndarë përvojat e tyre për ngjarjet e viteve 1998 dhe 1999. Ato kërkuan me ngulm zbulimin e kriminelëve të luftës. Kur panelistët bënë pyetje direkte se si do të reagonin ato kur do dihej se kush është kryerësi i veprës, reagimet kanë qenë të larmishme. Svetlana Velikic kërkoi që kriminelët të cilët kanë rrëmbyer vëllain e saj në vitin 1999, të marrin dënimin e merituar. Por disa gra sollën edhe dëshmi pozitive të policisë serbe dhe ushtarëve të cilët kishin shpëtuar disa individë shqiptarë gjatë luftës në Rahovec.

Në fund të takimit, 27 gra viktima të pranishme në këto konsultime nënshkruan Deklaratën për bashkëngjitje në Koalicionin për KOMRA dhe shprehën gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në takime të tjera të ngjashme, qoftë kombëtare apo rajonale, ndërsa gjithmonë në kërkim të së vërtetës për viktimat e krimeve të luftës.

Formatted: Croatian (Croatia)

Formatted

Formatted

Shqyrtim propozime, mendime dhe rekomandime

E vertata të del në pah pa marrë parasysh përkatësinë etnike

Formatted

'...normal, e vërteta duhet të zbardhet. Ka qenë çka ka qenë, ka ndodhur më 1999 si për ne, si për pjesën e serbëve, por prapë duhet ulur në një tryezë të rrumbullakët për të identifikuar problemet tona dhe personat që me të vërtetë neve çdo ditë na mungojnë... 'Ajo që më vret, është se që 12 vjet pas luftës të identifikohen njerëzit, të dihet varri. T'i lëmë dëshmipërblimet, se për një njeri të vdekur para ja s'është asgjë. Për ne është meritë e madhe që fëmijët tanë ta dinë ku e kanë babanë, ku e kanë nënën, apo familjarët tjerë të tyre. Këto kishin me qenë si lutje edhe për komunën. (Fahrije Hoti, OJQ "Nënat e Krushës së Madhe" Krusha e Madhe/Velika Kruša, Konsultimet nacionale me gra, viktimat të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted

E vërtata për hir të brezave të rinjë

'ne nuk do të mundemi kurrë dhe askush t'i kthejë ata njerëz të cilët janë të zhdukur, nuk ekzistojnë sot, as në të kaluarën, por të paktën të pushojmë që të akuzojmë, ose të na akuzojnë gjeneratat e ardhme'. (Shukrije Gashi, Partners Kosova, Prishtinë/Priština, Konsultimet nacionale me gra, viktimat të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted: German (Germany)

Nuk janë me rëndësi reparacionet financiare, unë dua të di ku janë eshtrat e të zhdukurve?

'...Po bëhen 12 vjet në mars, dua ta di dhe ta gjej, ta di ku është, ta varros në varrin e tij, asgjë tjetër nuk është më e rëndësishme, as paratë, asgjë tjetër, vetëm dua të ti ku është sepse 12 vjet unë nuk di asgjë për të'. (Todiq Stana, familjare e viktimës, Hoqa e Madhe/Velika Hoča, Konsultimet nacionale me gra, viktimat të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted

Komunikimi i ndersjellë do të ndihmonte pët formimin e një komisioni për gjetjen e së vërtetës për të dyja palët

Formatted

Megjithatë, për të formuar një komision, për me qenë dëshmitarë okularë që dëshmojnë me të vërtetë të vërtetën si nga pala jonë ashtu edhe nga pala e këtyre, atëherë do të mund të zgjidhim këtë problem dhe ti hulumtojmë rastet e krimit si të personave të pa gjetur, por edhe për personat e vrarë. Prandaj, deri sa ne nuk kemi komunikim, ndërmjet veti dhe i qesim në shesh, ata njerëz që vërtetë kanë bërë krime, prapë në daç nga ana e shqiptarëve, në daç nga ana e serbëve, kurrë nuk kemi me pas zbulim të personave të pagjetur ose zbulim të viktimave.

Formatted

'...Dëshmitarët që kanë punuar për një rreth të caktuar, kanë vrarë njerëz, kanë zhdukur njerëz dhe kanë informata të sakta, jo informata përmendësh, në bashkëpunim me komisionin që do të formohet, mund t'i hulumtojmë dhe zgjidhim ato probleme, të zbardhim fatin e personave të pagjetur, ti zbardhim krimet e luftës, sepse për ndryshe, kështu ne merremi me konferenca, dhe unë që 12 vjet merrem me konferenca për persona të pagjetur, asnjë rezultat nuk e kemi. (Fahrije Hoti, OJQ "Nënat

Formatted

e Krushës së Madhe”, Krusha e Madhe/Velika Kruša, Konsultimet nacionale me gra, viktimave të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted

Nuk ka falja të krimit!

Formatted: German (Germany)

Ky nuk e meriton faljen kurrë. T’ia fal Nenadit, kurrë nuk është e mundshme, se e di, kanë qenë fqinj të babit, shkojshim bashkë. Ai ka qenë me kunatin shokë dhe ashtu shkatërruan familjen tonë, kurrë nuk i falet më. Ai duhet të paguaj dënimin për krimin që e ka bërë, për gjithë Rahovecin... (Xhemile Sylka, familjare e viktimës, Rahovec/Orahovac, Konsultimet nacionale me gra, viktimave të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

KOMRA duhet të formohet për arsye se duhet të përpilohet një regjistër i të gjitha viktimave, të të vrarëve dhe të zhdukurve, dhe me këtë njëherë e përgjithmonë të pengohet manipulimi i të dhënave

Pse komisioni – KOMRA? Sepse, deri më tani janë thënë rastet, janë shpërndarë informatat, mirëpo në qoftë se nuk thuhet në mënyrë zyrtare, në mënyrë strukturore në komision, ka tendenca gjithmonë që ato të ndryshohen, të marrin trajtë tjetër, të shtohen, të shtrembërohen. Prandaj, është i nevojshëm krijimi i një komisioni i cili do të merret me vërtetimin, verifikimin e rasteve dhe për faktin gjithashtu se lufta ka ndodhur gjithandej në ish Jugosllavi dhe gjithkund ka ngjashmëri dhe kryerësit e këtyre veprave penale shpeshherë kanë qenë të njëjtit njerëz, prandaj është e rëndësishme pikërisht për këtë arsye që të krijohet KOMRA – komisioni rajonal dhe që familjarët e të zhdukurve, të viktimave, veteranëve të luftës, do të thotë, të gjitha grupet që janë më shumti të atakuara të sillen në komision dhe të dëshmojnë për krimet e luftës.

Përse KOMRA? ...edhe për arsyen se duhet që të përpilohet një regjistër i të gjitha viktimave të të humburve, të zhdukurve, me këtë njëherë e përgjithmonë të pengohet manipulimi, që pak më herët, njëra nga pjesëmarrëset këtu tregoi se ka kohë që kohë pas kohe merr informata se burri e djali janë diku dhe shpreson se do të kthehen. (Shukrije Gashi, Partners Kosova, Prishtinë/Priština, Konsultimet nacionale me gra, viktimave të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted

S’ka vend për falje!

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted

’Vetëm zoti le t’ja kthejë, le ta përjetojnë prindërit dhe motrat e tij, ashtu si jam ndjerë edhe unë’ ...’Do të doja që ai ta thoshte vetëm arsyen për të cilën e kanë vrarë. Sepse ai ishte i martuar, pas tre muajsh fitoi një vajzë, nuk e ka parë fëmijën e tij, i kishte vetëm 36 vjet. Për secilin është e rëndë ana e tij, secili qan për të vetin... (Manitasheviq Vesna, Shoqata e grave ’Jefimije’, Hoqa e Madhe/Velika Hoça, Konsultimet nacionale me gra, viktimave të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted

Nëse do të paraqitej dikush që do t’ju thoshte, unë e di se kush e ka vrarë babain tuaj, a do t’ja zbutnit dënimin kryerësit?

'...Kurrë!...'Le të marrë atë që ka merituar, le të dënohet'. (Miliq Brankica, familjare e viktimës, Hoça e Madhe/Velika Hoča, Konsultimet nacionale me gra, viktima të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted

Çdo viktimë dhe kryerës i veprës ka emër dhe mbiemër

'...çdo viktimë ka emër dhe mbiemër, njëjtë do të duhej që çdo kryerës i veprës të ketë emër dhe mbiemër, dhe jo i gjithë komuniteti...'Akoma nuk dihet kryerësi, ndërkaq do të doja ta dija. Vetëm më intereson arsyeja për të cilën është vrarë babai im'. (Tatjana Kolashinac, familjare e viktimës, Rahovec/Orahovac, Konsultimet nacionale me gra, viktima të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

A do të donit të ballafaqoheshit me vrasësin?

'Mua më intereson vetëm... Unë e di që atë prapë nuk mund ta kthej asgjë. Nëna ime vdiq me këtë dëshirë, ndërkaq unë do të dëshiroja vetëm ta di arsye? Jo. Ligji le ta gjykojë, unë nuk do të doja të ballafaqohem me të asnjëherë...sepse kaluan vite e vite me një mendim të vetëm: si ka qenë dhe si nuk do të arrijmë ta kuptojmë asnjëherë se si ka qenë në të vërtetë. Jeta vazhdon, mirëpo ne deri sa të jemi gjallë do të mendojmë për këtë. Unë kam thënë një mijë herë, edhe po ta vrisnin para nesh do ta dinim se çfarë kemi varrosur, por kështu edhe më tutje dyshojmë a është ai në të vërtetë, sepse kjo ishte vërtetë mizore, mirëpo nuk mund të heqësh dorë nga ajo ...' Unë nuk do të ballafaqohesha me të. Jo! Thjesht, vetëm ligji duhet të kryej punë për njerëz të tillë. Vëllain tim askush më nuk mund ta kthej... Do të doja të di kush është dhe të dënohet, sipas ligjit natyrisht, ndërkaq unë asnjëherë nuk do të isha në gjendje të gjykojë apo të bëj diçka'. (Svetlana Velikiq, familjare e viktimës, Rahovec/Orahovac, Konsultimet nacionale me gra, viktima të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted

Komunikimi dhe ndërrimi i informatave të jetë i ndërsjellë

Tash, i lus të gjithë serbet që i kemi të pranishëm, ne marrim masa për tuajt, por edhe ju merrni masa për tanët. Le të dalin këta që janë të zhdukur, të dimë ku i kanë eshtrat, sepse boll më, u bënë gati 12 vjet, presin fëmijët, presin nuset e reja se kur do t'u dalin eshtrat, sepse ne po e dimë çka ka ndodhur. Por, ju lutem, që keni informata, ju lutem lajmëroni në këtë pjesë ku jemi mbledhur. Ne për tuajt, që dimë diçka, të japim informata, por edhe ju në rast se dini diçka na jepni informata, sepse mjaft më u bënë 12 vjet, nuk është lehtë me i rritë nëna 7 fëmijë.. (Miradije Ramadani, familjare e viktimës, Krusha e Madhe/Velika Kruša, Konsultimet nacionale me gra, viktima të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted

Unë do të hakmerresha ndaj kriminelëve!

'...Po i drejtohem zonjës Muradije. Si e kishit marrë, nëse një kriminel është i zbuluar dhe ai ka vrarë burrin tënd? E kishit falë apo e kishit dënuar? Për shembull, nuk e kisha falur as s'e kisha dënuar. Po të më iplej mundësia unë do të hakmerresha. Nuk do ta lija edhe atë gjallë, njëjtë si baba i fëmijëve të mi që nuk jeton. (Fahrije Hoti, OJQ "Nënat e Krushës së Madhe", Krusha e Madhe/Velika Kruša, Konsultimet nacionale me gra, viktima të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

Formatted: Croatian (Croatia)

Jo falje!

Formatted

Katër muaj e gjysmë, ky 21-shi kur vjen, 12 vjet e 5 muaj. S'mrami herë...nuk di asgjë për të...
(Sheriban Ukshini, familjare e viktimës, Rahovec/Orahovac, Konsultimet nacionale me gra, viktimë të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

'Veç unë personalisht kurrë nuk ia fali. Le të harrojnë se ia fali, sepse 33 vjet burri i ka pasur kur është vrrarë...

Po, po, në burg të përjetshëm me shti. (Bademe Duraku, familjare e viktimës, Kruša e Madhe/Velika Kruša, Konsultimet nacionale me gra, viktimë të luftës, Rahovec/Orahovac, Kosovë 4 dhjetor 2010)

'...Vetëm pak, një përgjigje të shkurtër, Bademit, desha. Është cekur se Boshku ka bërë krime lufte. Po ne si OJQ, si këshill i fshatit kemi kontaktuar me të, jemi takuar, ai është plotësisht i pafajshëm. Kjo është se nuk mund të themi diçka si dëshmitarë'. (Fahrije Hoti, OJQ "Nënat e Kruhës së Madhe", Kruša e Madhe/Velika Kruša, Konsultimet nacionale me gra, viktimë të luftës, Rahovec, Kosovë 4 dhjetor 2010).

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: Serbian (Latin, Serbia and Montenegro (Former))

Formatted: German (Germany)

Formatted: German (Germany)

Formatted: German (Germany)